



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201600905/5

Tiranë ___/___/2016

Lënda : *Rekomandim për emërimin në detyrë të punonjësit të Policisë së Burgjeve R.T..*

Drejtuar : Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve
Z. Artur ZOTO

Tiranë

I nderuar zoti Zoto,

Me shkresat tona nr. K2/R9-2 Prot., datë 10.05.2016 dhe nr. K2/R9-4 Prot., datë 17.06.2016, ju kemi vënë në dijeni se në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi R.T.. Ankuesi shkruan se, ka qënë punonjës i Policisë së Burgjeve në IEVP Lezhë. Në datën 27.08.2015 ai është arrestuar për veprën penale të "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve", parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal për të cilën Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka filluar procedimin penal nr. 721 të vitit 2015.

Për shkak të arrestimit dhe fillimit të procesit penal ndaj tij, me urdhrin nr. 7805/2, datë 09.09.2015, të Drejtorit të Policisë së Burgjeve është vendosur pezullimin e tij nga funksioni, detyra e rolit bazë pranë IEVP Lezhë, deri në përfundim të procesit penal.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin e datës 05.01.2016 ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të tij, pasi nuk është provuar se ai është autor i veprës penale të "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve", parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Ndodhur në këto rrethana, pasi është bërë pushimi i hetimeve penale, ankuesi i është drejtuar me kërkesë për rikthimin në punë Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. Sipas tij, megjithëse kanë kaluar pesë muaj nga bërja e kërkesës së tij për rikthim në detyrë, ai jo vetëm që nuk është rikthyer në punë, por nuk i është kthyer as përgjigje lidhur me këtë kërkesë.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese dhe të pretendimeve të ankuesit, me shkresat e cituara më sipër ju kërkuam të na dërgonit shpjegime lidhur me këtë rast.

Ndonëse afati ligjor i kthimit të përgjigjes së kërkesave tona kaloi, ju nuk na e dërguat atë. Mosdërgimi i përgjigjes nga ana juaj për kërkesat tona përbën një qëndrim jo korrekt në përmbushjen e detyrave institucionale. Ndërkohë ky qëndrim ka sjellë mungesën e korrektesës tonë ndaj qytetarit për shqyrtimin e këtij rasti dhe kthimin e përgjigjes brenda afatit ligjor.

Pavarësisht mosdërgimit të përgjigjes tuaj, nga shqyrtimi i kësaj ankese konstatojmë se qëndrimi i mbajtur nga ana juaj ndaj ankuesit R.T. nuk është korrekt dhe ligjor. Sipas urdhrit nr. 7805/2, datë 09.09.015 të Drejtorit të Policisë së Burgjeve, ankuesi është pezulluar nga funksioni, detyra e rolit bazë pranë IEVP Lezhë, deri në përfundim të procesit penal të filluar ndaj tij. Kjo masë është e bazuar në nenin 42 të ligjit nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar. Pra kjo masë disiplinore i është dhënë ankuesit me kusht, deri në përfundimin e procedimit penal. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin e datës 05.01.2016, ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të tij, pasi nuk është provuar se ai është autor i veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Ndodhur në këto rrethana, menjëherë pas pushimit hetimeve në ngarkim të tij nga organi kompetent, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, ankuesi duhet të fillonte detyrën e pezulluar. Ndërkohë atij duhej ti jepeshin edhe të gjitha pagat për periudhën e qëndrimit pa punë për shkak të pezullimit. Megjithëse ju jeni njoftuar për pushimin e hetimeve penale në ngarkim të tij, nuk e keni kthyer atë në detyrë. Ndërkohë nuk keni reaguar edhe pasi ai ju ka bërë kërkesë me shkrim në datën 11.02.2016 dhe ju ka dërguar kopjen e vendimit të pushimit të hetimeve në ngarkim të tij.

Në rastin konkret ndodhemi para një procedure administrative të filluar me kërkesën e ankuesit. Në bazë të nenit 99 dhe 100 të Kodit të Procedurave Administrative, kjo procedurë duhet të përfundonte me një vendimmarrje përfundimtare tuajën, si organi administrativ kompetent, përkatësisht me një akt administrativ. Ndërsa në bazë të nenit 49/1 të këtij Kodi, kjo procedurë duhet të kishte përfunduar brenda 3 muajve.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese kemi arritur në konkluzionin se, nga ky qëndrim mosveprues shtetasit R.T. i janë shkelur të drejtat e garantuara nga aktet normative në fuqi dhe konkretisht ligji nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar, si dhe Kodi i Procedurave Administrative.

Për të rivendosur në vend të drejtat e cënuara ankuesit, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në nenin 21/b të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për emërimin në detyrë të punonjësit të Policisë së Burgjeve R.T..

2. Dhënien e pagave të pa paguara për periudhën e qëndrimit të tij të pezulluar nga funksioni.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditorë, sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI